REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 282/20
Datë/Datum. 09.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.282/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje individuale të: Blerim Dina - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Ejona" - Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve" me nr. të prok: 70030-20-1109-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Spitali i Përgjithshëm Pejë, më datë: 09.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Ejona" - Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve" me nr. të prok: 70030-20-1109-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Spitali i Përgjithshëm Pejë.

II. **ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve" me nr. të prok: 70030-20-1109-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Spitali i Përgjithshëm Pejë dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Ejona" - Pejë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Ejona" - Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.05.2020 me nr. 282/ 20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve" me nr. të prok: 70030-20-1109-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Spitali i Përgjithshëm Pejë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41.8, 41.10, 43.3 të RRUOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 20.05.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:
Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i shpallur fitues ka gabime aritmetikore në paramasën e dorëzuar të cilat çuditërisht AK nuk i ka vërejtur, tek pozicionet 29, 30 OE i shpallur fitues tek çmimi njësi ka vendosur çmimin për njësi me TVSH 59.00 euro, ndërsa tek Totali me TVSH ka vendosur çmimin 708.00. Ndërsa tek pozicioni 31, Çmimi për njësi me TVSH ka vendosur vlerën 23.60 Euro, ndërsa tek totali 283.20 Euro. Tek te këto tri pozicione njësia është Paushall (ku gjithmonë duhet të kalkulohet x1), e jo siç ka vepruar AK ku ka shumëzuar me 12, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Në formën siç është krijuar tabela për përshkrimin e çmimeve në dosjen e tenderit ka lënë mundësi të plotësimit të saj në dy mënyra për pozicionet nr. 29, 30 dhe 31. Edhe në mënyrë siç është plotësuar nga OE ankues, nuk paraqet gabime aritmetike në totalin e saj.
Në tabelën e çmimeve të ofertës së OE fitues, nuk ka asnjë gabim aritmetikorë në llogaritjen e çmimeve për asnjërin nga pozicionet në fjalë, siç e potencon OE ankues. Oferta e OE fitues pasqyron gjendjen e saktë financiare në totalin e saj sipas llogaritjeve matematikore në të tri pozicionet.
Nuk ka asnjë gabim aritmetik në llogaritjen e ofertës së OE fitues për pozicionet 29, 30 dhe 31 sepse

çmimi për njësi në këto pozicione është dhënë me TVSH, ndërsa te totali është llogaritur për 12 muaj, kërkesë kjo e dosjes së tenderit. E rëndësishme është që çmimi për njësi është i saktë në secilin pozicion dhe po ashtu edhe çmimi total për 12 muaj për të tri pozicionet është i saktë. Nuk ka tejkalim prej 2% te vlerës së ofertës financiare siç pretendohet. Prandaj, për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimorë është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues së Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 108/A, pasi që nuk ka respektuar afatet ligjore për parashtrim të ankesës në OSHP, dhe ka publikuar Njoftimin për Dhënie të Kontratës dhe në sistemin e E-Prokurimit, tash aktiviteti në fjalë figuron "ME KONTRATË", eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës ende pa kaluar afati për ankesa në OSHP nga operatorët ekonomik. Në këtë rast nga AK-ja nuk janë respektuar dispozitat e nenit 108/A për afatin e paraqitjes së ankesave. Megjithatë OE ankues ka bërë ankesë në OSHP dhe kjo ankesë është pranuar si valide për trajtim. Po ashtu, AK ka bërë anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës i cili është i publikuar edhe në platformën elektronike të KRPP-së. Prej këtij veprimi të AK-së nuk është dëmtuar OE ankues. Sidoqoftë, pretendimi ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues "Ejona" – Pejë, të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës në lidhje me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve" me nr. të prok: 70030-20-1109-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Spitali i Përgjithshëm Pejë.

Autoriteti Kontraktues, më datë 21.05.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, më datë 20.05.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e

komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ejona" - Pejë se OE i shpallur fitues ka gabime aritmetikore në paramasën e dorëzuar të cilat çuditërisht AK nuk i ka vërejtur, tek pozicionet 29, 30 OE i shpallur fitues tek çmimi njësi ka vendosur çmimin për njësi me TVSH 59.00 euro, ndërsa tek totali me TVSH ka vendosur çmimin 708.00 euro. Ndërsa tek pozicioni 31, çmimi për njësi me TVSH ka vendosur vlerën 23.60 Euro, ndërsa tek totali 283.20 euro. Tek të këto tri pozicione njësia është paushall (ku gjithmonë duhet të kalkulohet x1), e jo siç ka vepruar AK ku ka shumëzuar me 12.
Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues ku potencon se "gjithmonë duhet të kalkulohet x 1" ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nga çmimi për njësi tek pozicioni 31 ka dhënë çmimin prej 26.30 euro, kurse totali me TVSH 283.20 euro, për Panelin Shqyrtues është e pakuptimtë për shkak se **pika "a"** e neni 41.9 të RRUOPP-së ka përcaktuar që çmimi i njësisë mbizotëron, ku thuhet: *"Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:*
a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është marrë duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet".
Pra, për Panelin Shqyrtues është e pa qartë se si AK ka bërë vlerësimin e tenderëve kur çmimin njësi ka kalkuluar me 12 muaj. Rrjedhimisht, dispozita e cekur me lartë ka përcaktuar që çmimi për njësi duhet shumëzuar me sasinë, ndërsa në rastin konkret është shumëzuar me muaj.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Ejona" - Pejë së Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 108/A, pasi që nuk ka respektuar afatet ligjore për parashtrim të ankesës në OSHP, dhe ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës dhe në sistemin e E-Prokurimit, tash aktiviteti në fjalë figuron "Me Kontratë".
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës ende pa kaluar afati për ankesa në OSHP nga operatorët ekonomik. Në këtë rast nga AK-ja nuk janë respektuar dispozitat e nenit 108/A për afatin e paraqitjes së ankesave. Megjithatë OE ankues ka bërë ankesë në OSHP dhe kjo ankesë është pranuar si valide për trajtim. Po ashtu, AK ka bërë anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës i cili është i publikuar edhe në platformën elektronike të KRPP-së. Prej këtij veprimi të AK-së nuk është dëmtuar OE ankues. Megjithatë, pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve duhet që t'i vërtetoj pretendimet e OE ankues duke vlerësuar dhe ekzaminuar tenderët konform kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- "Spitali i Përgjithshëm - Pejë",

1x1 OE - "Ejona" - Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.